

## Dyzet hadithe të Imam Neveviut

1. Transmetohet nga prijësi i muslimanëve Ebi Hafsi Omer b. Hatabi r.a., i cili ka thënë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem: "Vërtetë veprat çmohen sipas qëllimeve dhe se Çdo kush do të shpërblehet sipas asaj që ka vendosur. Ai që ka migruar për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, migrimi i tij është për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Ai që ka migruar për ndonjë të mirë të kësaj bote ose për ndonjë femër që të kurorëzoj. Migrimi i tij është për atë që ka migruar." Çdo vepër edhe nëse nuk mund të realizohet do të shpërblehet në bazë të qëllimit. Migrim do të thotë shpërngulje prej një vendi në vendin tjetër. Shpërngulja që theksohet në hadith fjala është për migrimin e muslimanëve prej Mekës në Medinë. Nga hadithi nxirret përfundimi: Sinqeriteti është çështje parimore si në vepër ashtu edhe në adhurim.

2. Transmetohet nga Omeri r.a., i cili ka thënë: për derisa ishim ulur në një ditë të Dërguarit i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem u shfaq një njeri me rroba shumë të bardha dhe me mjekërr shumë të zezë por, nuk vëreheshin ke ai gjurmët e udhëtimit dhe as kush nga ne nuk e njihte. Erdhi dhe u ul te Pejgamberi, i ngjiti gjujt e vetë me gjujt e atij, i vëndoi shuplakat mbi gjunjët dhe, tha: O Muhamed më informo për Islamin? "Islam është të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij; të falësh namazin, të jepësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të vizitosh Shtëpinë e Shenjtë nëse ke mundësi udhëtimit ke ajo", u përgjigj Pejgamberi. Të vërtetën e ke thënë ia ktheu njeriu. Në çuditësim (pohon Omeri) ai parashtronte pyetje dhe e vërtetonte përgjigjrrn. Më informo për besimin (imanin) pyeti së dyti? "Të besosh në Allahun, në engjëjt, në librat, në të dërguarit dhe në ditën e Mbrame, ti besosh caktimit, të mirës dhe të keqës", u përgjigj Pejgamberi. Të vërtetën e ke thënë ia ktheu ai. Më informo për sinqeritetin, pyeti njeriu? "Të adhurosh Allahun sikur ti e sheh edhe pse nuk mund ta shohësh Ai të sheh ty", u përgjigj Pejgamberi. Më informo për çastin e fundit. "Ai që pyetët nuk është më i ditur se ai që pyet", u përgjigj Pejgamberi. Më informo për shenjat e saj? "Kur të lind nëna zotëriun e saj, kur t'i shohësh të zbathurit, barinjët ndërtojnë godina të larta", i tha Pejgamberi. Pstaj ai u largua dhe Omeri thotë: kam qëndruar disa çaste dhe Pejgamberi i tha Omerit: A e di se kush ishte pyetësi?" Allahu dhe i Dërguar i Tij më së miri e di, ia ktheu Omeri. "Ai ishte Xhebraili erdhi që t'ua mësoj juve fenë." Të pranishmit çuditëshin me njeriun, i cili i parashtronte pyetje Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem. ?uditëshin sepse ai parashtronte pyetje ndërkohë e vërtetonte përgjigjen. Parashtrimi i pyetjeve tregonte mosdijen e tij nga ana tjetër vërtetimi i asaj që përgjigjej Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem tregonte të kundërtën. Nga hadithi nxirret përfundimi: Muslimani duhet të jetë i pastër në veshmbathje dhe i zbukuruar në formën e jashtme. Futja në një shoqëri paraprakisht motivon marrjen e lejes për prezentim në atë shoqëri dhe njëkohësisht duhet përshëndetur ata me selam. Engjëjt kanë mundësi të formësohen në fizionomi të njeriut.

3. Transmetohet nga Abdurrahman Abdullah Ibni Omer Ibni el-Hattab r.a.h., i cili ka thënë: e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, i cili thoshte: "Islami është ngritur mbi pesë (shtylla): Dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dëruari i Tij; falja e namazit, dhënia e zekatit, haxhi - vizita e Shtëpisë së shenjtë- dhe agjërimi i Ramazanit". Namazi duhet të falet rregullisht me kushte dhe kondita të plota duke i zbatuar sunnetet dhe rregullat përkatëse të namazit. Nga hadithi nxirret përfundimi: Islami është bindje (besim) dhe veprim praktik. Nuk ka vlerë puna e atij që nuk ka bindje të thellë as nuk mund të eksistoj bindja e plotë përderisa nuk ia bashkangjet bindjes së vetë veprimin praktik.

4. Transmeton Abdurrahman Abdullah b. Mes'udi r.a., i cili ka thënë se na ka treguar i Dërguarit i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, e ai është i vërtetë në atë që iu është shpallur atij: "Ndokush nga ju dyzetë ditë grumbullohet spermë në barkun e nënës së vetë, po aq ditë më pas përmbledhet në formë të gjakut të ngjizur, po aq ditë më pas përmbledhet në formë të kafshatës së mishit pastaj i dërgohet meleku, i fryn shpirtin dhe e porositë me katër gjëra; i caktohet (shkruhet) rizku, jeta, vepra, i dëshpëruar do të jetë ose i gëzuar. Betohem në Atë që nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Ndokush nga ju do të veproj punë të xhenetliut sa që distanca në mes tij dhe xhenetit nuk do të jetë sa një krah. Do ti paraprij libri (caktimi i mëhershëm) dhe do të veproj vepra të popullit të xhehenemit dhe do të futet në të. Ndokush nga ju do të bëj vepra të popullit që

do të futet në zjarr sa që në mes tij dhe zjarrit nuk do të jetë distance sa një krah do t'i paraprij libri (caktimi i mëhershëm) dhe do të veproj vepra të popullit të xhenetit dhe do të hyjë në të." Çdo gjë ndodhë me caktimin e Allahut dhe është në diturinë e pakufishme të Krijuesit të gjithësisë. Rrjedhoja e veprimeve ndodhë sipas përcaktimit vullnetar dhe zgjedhjes së vetë njeriut. Nga hadithi nxirret përfundimi: Kënaqësia, gëzimi, hareja dhe pikëllimi janë çështje të caktuara para lindjes së njeriut. Veprat çmohen në bazë të rezultatit përfunduar.

5. Transmetohet nga nëna e muslimanëve, Ummi Abdulla - Ajsheja r.a.h. e cila ka thënë: "I Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Ai që shpikë diç që nuk i përket fesë tonë është jo e pranueshme." Sipas transmetimit të Muslimit: " Ai që vepron ndonjë vepër që nuk i përket fesë tonë është jo e pranueshme". Çdo vepër që nuk bazohet në argumente fetar (Kur'an dhe Sunnet) është jo e pranuar prej anë së Allahut xh.sh.

6. Transmetohet nga Abdullah Nu'man b. Beshiri r.a., i cili ka thënë e kam dëgjuar të Dërguarin sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, i cili thoshte: "Hallalli është i qartë edhe harami është i qartë por ka në mes tyre (vepra dispozita e të cilave) është jo e qartë dhe shumica e njerëzve nuk e dinë. Ai që largohet prej tyre ka shfajtuar fenë dhe nderin e tij. Ai që kontakton me veprat (që kanë dispozitë jo të qartë) ka kontaktuar me (veprën që është) e ndaluar (haram), sikur bariu që i ruan bagëtitë në kullosë në skaj të zonës së ndaluar. Çdo mberet ka zonë të ndaluar, zonë e ndaluar e Allahut janë ndalesat e Tij. Në trup ka një kafshatë mishi nëse ajo është në rregull i gjithë trupi është në rregull, nëse ajo është e sëmurë është i sëmurë i tërë trupi, e ajo është zemra". Hadithi bënë nxitje në vepra të mira dhe të lejuara, ndërkaq ndalon veprat e këqia (e të ndaluara). Gjithashtu i nxitë besimtarët që të largohen nga veprat dispozita e të cilave nuk është e qartë, respektivisht, që nuk dihet se a është e lejuar fetarisht apo e ndaluar. Nga hadithi nxirret përfundimi: Të gjitha mënyrat, mjetet dhe veglat që shpiejnë në gjëra të ndaluara duhet vënë drynin atyre.

7. Transmetohet nga Ebi Rukajje Temin Ed-dari r.a. se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Feja është këshillë". Të pranishmit i thanë: Për çka? "Për Allahun, për librin e Tij (Kur'anin) për të Dërguarin, për liderët e muslimanëve dhe për mbarë qytetarët ", u përgjigj Pejgamberi. Feja që theksohet në këtë hadith fjala është për Fenë islame. Nga hadithi nxirret përfundimi: Këshilla duhet të jetë për Fenë Islame. Fe do të thotë bindje dhe veprim. Këshilla është domosdoshmëri në shkallë të mundësisë.

8. Transmetohet nga Ibni Omeri radijall-llahu anhu, i cili ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, thoshte: "Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit (jobesimtarët) derisa të dëshmojnë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij, të falin namazin dhe të japin zekatin. Nëse këtë ata e bëjnë kanë të mbrojtur nga unë gjaqet dhe pasuritë e tyre me përjashtim të të drejtës islame, ndërkaq llogaria e tyre përfundimtare mbetet te Allahu i Madhëruar". Përqafimi i Fesë Islame motivon siguri personale dhe mrojtje të pasurisë. Gjakëderdhja e muslimanit është e ndaluar dhe keqpërdorimi i pronës së tij përveç me të drejtën islame kur shkelën normat fetare, kur nuk zbatohen detyrat obligative ose kur nuk hiqet dorë nga gjërat e ndaluara atëherë ekzekutohet dënimi paraprak i Sheriatit Islam. Llogaria përfundimtare e veprave sekrete të njeriut shpërblime qofshin ose ndëshkime janë çështje që i përkasin vetëm Krijuesit të Gjithësisë. Nga hadithi nxirret përfundimi: Feja Islame garanton jetën, mbronë gjakëderdhjen dhe pronën e besimtarit. Namazi dhe zekati janë kondita me vlerë të lartë islame.

9. Transmetohet nga Ebi Hurejre Abdurrahman b. Sahar r.a., i cili ka thënë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, thoshte: "Nga ajo që u kam ndaluar juve heqni dorë (largohuni), kurse me atë që u kam urdhëruar juve veproni sa të keni mundësi ngase janë shkatërruar ata që ishin para jush me parashtimin shumë të pyetjeve (të panevojshme) dhe luhatëshmëria (diskutimet dhe grindjet) kundër pejgamberëve e tyre". Dëgjueshmëria dhe nënshtrimi janë rruga e shpëtimit dhe e mbarësisë. Parashtrimi i pyetjeve të panevojshme, diskutimet dhe divergjencat në përshtjellimin e gjërave ishte shkas për shkatërrimin e popujve të kaluar.

10. Transmetohet nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë: i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Allahu është i zhveshur nga Çdo e metë dhe nuk pranon (asnjë vepër) vetëm atë

që kryhet në emër të Tij. Allahu i ka urdhëruar besimtarët me atë që i kishte urdhëruar të dërguarit dhe (lexoi ajetin kur'anor): "O ju të dërguar, hani atë që është e lejuar dhe e mirë dhe bëni vepra të mira se Unë e di atë që ju veproni." (Gjithashtu lexoi ajetin): "O ju që besuat, hani nga të mirat që ua kemi dhënë dhe falënderoni All-llahun, nëse jeni që vetëm Atë e adhuron." Pastaj tregoj rasin e një njeriu, i cili e zgjatë rrugëtimin i pakrehur dhe i pluhurosur. I zgjatë duartë kah qielli: o Zot, o Zotë, ushqimi i tij është me haram, pija me haram, veshmbathja me haram, është furnizuar (ushqyer) me haram prej nga atij pranohet lutja!!?". Hadithi i nxitë besimtarët të shpenzojnë atë që është fituar nga hallalli njëkohësisht e ndalon shpenzimin nga fitimi jo iligjshëm. Ai që ka dëshirë lutja t'i pranohet duhet të mbajë llogari për ushqimin, pijen dhe veshmbathjen të jetë e fituar në mënyrë të ligjshme - hallall.

11. Transmetohet nga Ebi Muhamed Hasen b. Ali b. Ebi Talib, nipi i të Dërguarit të Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem dhe borziloku i tij, ka thënë: Kam mësuar nga i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem: "Lëre atë që dyshon në atë që nuk dyshon". Dispozitat, çështjet jetësore duhet bazuar në të sigurtë. Fitimi i ligjshëm (hallali), e vërteta dhe sinqeriteti janë qetësi dhe kënaqësi, kurse fitimi jo i ligjshëm (harami), pavërtetësia, gënjeshtria janë dyshim dhe neveri.

12. Transmetohet nga Ebu Hurejreja r.a. se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Fe e plotë e personit është të heq dorë nga gjërat që nuk i interesojnë". Veçori e muslimanit është marrja me çështje madhore dhe largimi nga veprat degraduese të pamoralshme. Hadithi udhëzon në edukimin shpirtëror, në rafinimin e tin dhe në heqjen dorë nga gjërat e pavlefshme.

13. Transmeton Ebu Hamza Enes b. Malik r.a. - shërbetor i Dërguarit të Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, i cili ka thënë: "Nuk ka besim të përkryer ai që nuk dëshiron për vëllain e vetë atë që dëshiron për veten". Hadithi i stimulon besimtarët në shndëritjen e zemrave të njerëzve dhe në veprimin drejt ndaj rrethanave të tyre. Kjo është pika më me rëndësi e Fesë Islame për të cilën u shpall ajo. Nga hadithi nxirret përfundimi: Besimi shtohet dhe pakësohet. Besimi shtohet duke iu nënshtruar urdhërave hyjnore kurse pakësohet duke bërë mëkate.

14. Transmetohet nga Abdullah b. Mes'udi se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Nuk lejohet vrasja (gjakderdhja) e personit musliman që dëshmon se nuk ka Zotë tjetër përveç Allahut (dhe që dëshmon se) unë jam i Dërguar i Tij, (përrjashtim nga ky rregull bëjnë) tre (grupe njerëzish); i martuari që bënë prostitucion, vrasësi i një jete dhe ai që dezerton (brakëtisë) shumicën e muslimanëve". Hadithi i stimulon besimtarët të veprojnë në bazë të asaj që janë shumica e muslimanëve njëkohësisht ua tërheq vëmendjen atyre që të mos dezertojnë nga ata. Muslimani duhet të ruhet nga mëkatet në përgjithësi e në veçanti duhet patur kujdes nga këto tre mëkate që i përmend hadithi me theks të veçantë. "Hududet" në islam – dënimet e caktuara fetre" janë tmerruese por kanë për qëllim sigurinë dhe mbrojtjen.

15. Transmetohet nga Ebu Hurejreja r.a., ky nga i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, i cili ka thënë: "Ai që i ka besuar Allahut dhe Ditës së mbrame le të fletë mirë ose le të heshtë. Ai që i ka besuar Allahut dhe Ditës së mbrame le të nderoj fqin e vetë. Ai që i ka besuar Allahut dhe Ditës së mbrame le të nderoj mysafirin e vetë". Aspiratë e muslimanit gjithnjë duhet të jetë të folurit e dobijshëm. Njëkohësisht besimtari në të gjitha situatat duhet të largohet nga të folurit e ndaluar. Hadithi bënë të ditur se shkaktimi dëmë fqit është si pasojë e mangësisë shkatërruese të besimit nga ana tjetër nderimi i mysafirit është pjesë e besimit dhe virtyt i lartë islam.

16. Transmetohet nga Ebu Hurejreja r.a. që një njeri kishte kërkuar nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem që ta udhëzoj. Atij i kishte thënë: "Mos u hidhëro!" Këtë ia përsëriti disa herë duke i thënë: "Mos u hidhëro!". Hidhërimi shkakton ngacmim shpirtëror në ngjalljen e dëshirës për dhunë dhe hakmarrje. Nga hadithi nxirret përfundimi. Të folurit pak dhe të vepruarit shumë janë gjëra të preferuara. Edukimi në shembullin e lartë dhe toleranca janë shkas për kënaqësi dhe shpëtim të përhershëm.

17. Transmetohet nga Ebi Ja'la Shed-dad b. Evsi r.a., ky nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, i cili ka thënë: "Vërtet Allahu ka bërë obligim mirësinë ndaj Çdo gjëje: Kur ta mbytni (p.sh. armikun), mbytni në mënyrën më të mirë; kur të therrni, therrni në mënyrën më të mirë; mprehni thikat që t'ia lehtësoni sakrificës suaj". Ky hadith është një shtyllë prej shtyllave të rëndësishme të fesë. Përfshinë përkujdesjen ndaj mësimave islame, sepse ka të bëjë me bëmirsinë në vepër, e ajo arrihet kur është në përputhje me rregullat islame. Veprat ose kanë të bëjnë me jeten e njeriut të kësaj bote ose me jetën tjetër. Kush është bëmirs në punët e kësaj bote dhe të botës tjetër është i shpëtuar.

18. Transmetohet nga Ebu Dherr, Xhundub ibn Xhunadete dhe nga Ebu Abdurrahman, Muadh ibn Xhebeli, radijellahu anhumas se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme ka thënë: "Kijë frikë Allahun kudo që të jesh. Pas Çdo vepre të keqe bëre një vepër të mirë, ajo do ta fshijë të keqen dhe sillu me njerëzit me moral të mirë". Besim i përsosur dhe cilësi e njerëzve të devotëshëm është morali i lartë dhe mirësjellja. Dëvotëshmëri e përsosur është kur njeriu urren mëkatarët dhe shmanget nga ndeja me ata në tubime.

19. Transmetohet nga Ebul-Abbas Abdullah ibn Abbasi, radijellehu anhumas, i cili ka thënë: Një ditë kam qenë pas të Dërguarit të Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem dhe më tha: "O djalosh unë do t'i mësoj ty disa fjalë." Ruaje fenë e Allahut se Allahu ty do të ruajë. Ruaje fenë e Allahut, Allahun do ta gjejsh para teje. Kur të kërkosh, kërkohet prej Allahut. Nëse kërkon ndihmë, kërkohet prej Allahut. Dije, sikur tërë populli të tubohet që të të ndihmojë në diç, nuk do të të ndihmonin, përveç atë çka të ka caktuar Allahu. E nëse do të tuboheshin që në diç të të bëjnë dëm, nuk do të dëmtonin, përveç në atë çka Allahu e ka caktuar. Janë ngritur pendat dhe janë tharë fletat". Mësuesi duhet të ngjallë kurejshtje dhe t'ia tërheq vëmendjen nxënësit për dituri. Ai që e mbron të drejtën e vetë, që e ngritë zërin për të vërtetën, që urdhëron në të mirë dhe që ndalon nga e keqja nuk do të mund ta dëmtojë atë dinakëria e tiranëve as dredhia devijuese e armiqëve të Allahut.

20. Transmetohet nga Ebu Mes'udi Ukbe ibn Amër el-Ensarij el-Bedri, radijellahu anhu, se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Vërtet, nga fjalët (urtësitë) që ka mbajtur mend njerëzia nga predikimet e pejgamberëve të mëparshëm është: Nëse nuk turpërohesh vepro çka të duash". Turpi është fund e krye mirësi. Ai që shumë turpërohet posedon shumë të mira, ai që nuk turpërohet nuk posedon të mira. Nuk është turp të kërkohet e drejta (e vërteta) dhe dituria.

21. Transmetohet nga Ebu Amri - e sipas disave Ebu Amrete-, Sufjan ibn Abdullah Eth-Thekafij radijellahu anhu, i cili ka thënë: Thashë: O i Dërguari i Allahut! Më thuaj diç në Islam që të mos kem nevojë të pyes askend tjetër përveç teje?: "Thuaj: "I kamë besuar Allahun, pastaj qëndro (në atë)". Qëndrueshmëria, sinqriteti në "tevhid-monoteizëm" dhe në adhurim është çështje permanente. Shokët e Pejgamerit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem kanë shprehur interesim të madh për çështje fetare në ruajtjen e besimit të tyre.

22. Transmetohet nga Ebu Abdullah Xhabir ibn Abdullah El-Ensarij, r.a.h. "Një njeri e pyeti të Dërguarin e Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem se nëse do t'i falë namazet e obliguara, do të agjëroj Ramazanin, do t'iu përmbahet të lejuarave do të heq dorë nga të ndaluarat dhe nuk do të bëjë asgjë më shumë nga kjo, a do të hyjë në xhennet? " Po", ishte përgjigjur Pejgamberi alejhis-selam. (Muslimi). Cdo besimtarë obligohet t'i parashtroj pyetje dijetarëve për dispozitat fetare që nuk i di, me qëllim që diç atë se cila vepër është e lejuar e cila është e ndaluar. Detyrë e mësuesit është që ta furnizoj nxënësin me dituri të gjerë dhe të jetë i butë dhe i sjellshëm ndaj tij.

23. Transmetohet nga Ebu Malik El-Harith ibn Asim El-Esh'arij r.a., i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme, ka thënë: "Pastërtia është gjysma e besimit. Falenderimi ndaj Allahut (el-hamdi lil-lah) e mbushë peshojën. Lavdërimi dhe falënderimi i Allahut (sub'hanell-lahi vel-hamdu lil-lahi) e mbushin hapësirën mes qiellit dhe tokës. Namazi është dritë. Sadaka është dëshmi, durimi është shkëlqim. Kurse Kur'ani është dëshmi për ty ose kundër teje. Çdo kush fillon ditën e vetë dhe Çdo njëri është tregtar i vetes së tij; mund të punojë punë të mira e ta

lirojë veten ose të punojë punë të këqija e ta shkatërroja veten". Besimi është bindje dhe vepër praktike, shtohet dhe pakësohet. Besimi shtohet duke iu nënshtruar urdhërave të Fesë islame ndërkaq pakësohet duke bërë mëkate. Nga hadithi nxirret përfundimi: Namazi obligativ duhet të falet pesë herë në ditë në kohë të vetë. Sadaka në vepra të mira duhet shpenzuar sa më tepër. Çështjeve jetësore e fetare, të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja duhet përballuar me durim.

24. Transmetohet nga Ebu Dherr El-Gifarij, r.a. se Pejgamberit salallahu alejhi ve selem, i është transmetuar nga Krijuesi i Lartësuar, i cili ka thënë: "O robët e Mi! Unë ia kam ndaluar padrejtësinë Vetes dhe e kam ndaluar edhe ndër ju, prandaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit. O robët e mi! Të gjithë ju jeni të humbur përveç ai që Unë e udhëzoja, prandaj kërkoni udhëzime nga Unë, do t'ju udhëzoj. O robët e mi! Të gjithë jeni të uritur, përveç ai që Unë e ushqej, prandaj kërkoni që t'ju ushqej, do t'ju ushqej. O robët e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur, përveç ai që Unë e veshi, prandaj kërkoni veshje nga Unë, do t'ju veshi. O robët e Mi! Vërtet ju gaboni natën dhe ditën, kurse Unë i fali të gjitha mëkatet, prandaj, kërkoni nga Unë falje, do t'ju fali. O robët e Mi! Kurrë nuk do mund të arrini Mua dëm të më shkaktonit, që të më dëmtonit, as që ndonjëherë do të arrini tek ajo që Mua dobi të më sjellni, që të më kontribuonit. O robët e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, njerëzit nga ju dhe xhinnët të ishin të devotshëm sikur zemra më e më të devotshmit nga ju, nuk do ta shtonte asgjë në sundimin Tim. O robët e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit, njerëzit dhe xhinnët të ishin të prishur si zemra më e prishur e njërit prej jush, nuk do ta mungonte asgjë në sundimin Tim. O robët e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit, njerëzit dhe xhinnët të ngriteshin (qëndronin) në një vend, dëshirat dhe lutjet të m'i drejtonin Mua dhe Unë lutjes së Çdo njeri t'i përgjigjesha. Nuk do ta mungonte kjo atë që Unë e kamë sa mund gjilpëra të pakësoj detin kur ngulitet. O robët e Mi! Cdo gjë varet nga veprat tuaja, të cilat te Unë jan të ruajtura dhe të llogaritura për të cilat Unë do t'ju shpërblej juve. Kush gjenë mirë, le ta falënderojë Allahun ndërkaq kush gjenë të kundërtën, të mos e fajësoj askë përveç veten". Muslimani duhet të jetë i edukuar dhe i moralshëm. Gjithashtu duhet të kërkoj nga Krijuesi i gjithësisë mbulesë për veprat që shifen e që nuk shifen. Krijuesi i gjithësisë duhet zhveshur nga Çdo atribut që nuk i përket Madhërisë së Tij.

25. Transmetohet nga Ebu Dherri r.a. disa shok të të Dërguarit të Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thane: "O i Dërguari i Allahut!: "Pasanikët shkuan dhe i mblodhën shpërblimet (sevapet), falen sikur falemi, agjërojnë sikur agjërojmë dhe ndajnë sadakë nga pasuria e tyre (që u tepron)! "A nuk iu ka mundësuar Allahu xh.sh. edhe juve të ndani sadakë", pyeti Pejgamberi alejhis-selam? Vërtet në Çdo tesbih (thënie sub'hanellah) ka sadakë; në Çdo tekbir (thënie Allahu ekber) ka sadakë; në Çdo tehmid (thënie El-Hamdu lil-lah) ka sadakë; në Çdo tehliil (thënie La ilahi el-lall-llah) ka sadakë, në urdhërin për të mirë ka sadakë, në ndaljen nga e keqja ka sadakë dhe në të kënaqurit e epsheve ka sadakë! Të pranishmit thanë: "O i Dërguari i Allahut, a edhe kur ndonjëri prej nesh i kënaq epsheet e veta dhe për atë ka shpërblim? Cka mendoni, sikur epshin e vet ta kënaqë në mënyrë të ndaluar, a nuk do të meritonte mëkatën (dënimin)", pyeti Pejgamberi?! Njëashtu pra kur të kënaqet në mënyrë të lejuar, do të ketë shpërblim". Mençuria në momente të caktuara (urtësia), është çështje e kërkuar për trajtimin gjërave. Nga hadithi nxirret përfundimi: Përgëzimi për mbarim të mirë të veprave. Vlera e të urdhëruarit në të mirë dhe ndalimi nga e keqja. Vlera e intimitetit me bashkëshorten dhe përmbushja e obligimeve ndaj saj.

26. Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a., se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Cdo ditë që lindë Dielli, në Çdo nyje (të trupit) të njeriut ka sadakë; të pajtosh dy vetë është sadakë; të ndihmosh njeriun të hypë në kafshë, t'ia bartësh ose t'ia ngritësh bagazhin është sadakë. Fjala e mirë është sadakë, Çdo hap që ndërron për të shkuar me falur namaz është sadakë, të shmangësh nga rruga pengesën është sadakë". Për organizëm jepet zekatë ashtu siç jepet zekatë për pasurinë. Zekat i organizmit është në vepra të mira. Nga hadithi nxirret përfundimi: Dyertë e mirësive në Islamë janë të nduarnduarta.

27. Transmetohet nga En-Nuvvas ibn Sem'ani r.a. se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-leme, ka thënë: "Mirësia është morali (karakteri) i mirë, kurse e keqe (mëkat) është ajo që të ngacmon në veten tënde dhe që nuk dëshiron ta dijë njerëzit". Gjithashtu transmetohet nga Vabisete ibn

Ma'bedi r.a., i cili ka thënë: "Kam shkuar te i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-leme: "Ke ardhur të pyesish se ç'është mirësia" i tha Pejgamberi? Po, u përgjigj ai. "Konsulto zemrën tënde", i tha Pejgamberi. Mirësia është ajo çka e qetëson shpirtin dhe që qetëzohet zemra jote. Ndërsa mëkat është ajo që të ngacmon në shpirtë dhe të le të hamendur në zemër. (Vepra sipas kësaj) edhe pse njerëzit të japin fetva ndryshe nga kjo". Morali i mirë është prej veçorive më madhore të mirëbërësisë. Nga hadithi nxirret përfundimi: Feja Islame fuqimisht ka ndaluar të bërit krime (mëkate) për faktin se zemrat e njerëzve kontrollohen drejtë-përdrejtë nga Krijuesi i gjithësisë. Për dallim nga ligji pozitiv i cili sundon shpirtin vetëm nga aspekti i jashtëm.

28. Transmetohet nga Ebu Nexhij Irbad ibn Sarijeh, radijellahu anhu i cili ka thënë: Na këshilloj i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem me këshillë nga e cila zemrat janë frikësuar dhe sytë janë përplotur. Atëherë thamë: O i Dërguari i Allahut, sikur që kjo është këshillë lamtumirëse, prandaj na porositë. "Ju porositi me devotshmëri ndaj Allahut të Lartëmadhëruar, me dëgjueshmëri, nënshtrim ndaj emirit (kryetarit) edhe sikur ai të ishte rob. Vërtet, gjatë jetës suaj do të përjetoni shumë divergjenca. Ju jeni të obliguar të kapeni për sunnetin tim dhe sunnetin e halifëve të drejtë. Kapuni për të me dhëmballët tuaj. Ruanu prej risive (bid'ateve) sepse Çdo risi është humbje". Cdo risi për derisa nuk ka mëshjetje në argument fetar është e ndaluar. Instruksionet, porositë ose udhëzimet para nisjes për në udhëtim janë sunnet.

29. Transmetohet nga Muadh ibn Xhebeli, radijellahu anhu, i cili ka thënë: Thashë: O i Dërguari i Allahut, më trego një punë që do të më shpie në xhennet dhe do të më largoj nga zjarri. "Ke pyetur për një çështje të madhe, ia ktheu Pejgamberi, ajo është e lehtë për atë, të cilit Allahu ia lehtëson: Adhuro Allahun dhe Atij mos i shoqëro asgjë, fale namazin, jepe zeqatin, agjëro Ramazanin dhe bënë haxhin". Pastaj i tha: "A dëshiron të të nxisë në dyertë e së mirës (hajrit): agjërimi është mburojë, sadaka e zhdukë mëkatin sikur që uji e fik zjarrin dhe namazi i njeriut në thellësi të natës", pastaj lexoi ajetin kur'anor: "Ata ngriten nga shtretërit" deri sa arriti te fjala "ja'melune (veprojnë)". Pastaj ka thënë: "A dëshiron të të tregoj kokën e çështjes, shtyllën dhe kulminacionin e saj? Po! o i Dërguari i Allahut, ia ktheu ai. "Koka e çështjes është islami, shtylla është namazi kurse kulmi është xhihadi", u për gjigj Pejgamberi. Pastaj tha: "A dëshiron të të tregoj për supervizorin e gjithë kësaj? Po si jo, o i Dërguari i Allahut. Atëherë ai e kapi gjuhën e tij dhe tha: "Ruaje këtë". I thashë: O Pejgamber i Allahut, a do të përgjigjemi edhe për atë që flasim? "I mjer ti o Muadh, ta merr mendja se diç tjetër i përmbys njerëzit me fytyrë në zjarr - ose ka thënë - me hundë, përveç të korrurat nga gjuhët e tyre." Shokët e Pejgamberit sal-lallahu alejhi vesellem, sahibët, vashdimidht kërkonin këshilla dhe udhëzime nga i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi vesellem. Nga hadithi nxirret përfundimi: Zbatimi i pesë konditave islame shkakton futjen në xhennet. Vlera e xhihadit në ruajtjen e parimeve islame në ngritjen lartë të Fjalës së Allahut xh.sh. Fjalët e pakontrolluara, përkatësisht, gjuha shkakto futjen në zjarr.

30. Transmetohet nga Ebu Tha'lebe El-Hushenijji, Xhurthum b. Nashir, radijellehu anhu, ky nga i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve seleme, i cili ka thënë: "Vërtetë Allahu i Madhëruar i ka caktuar farzet, ju mos i lini pas dore. I ka caktuar kufijtë (dënimet) për Çdo gjë, ju mos i tejkaloni. I ka ndaluar disa gjëra, ju mos i praktikoni. Ka heshtur ndaj disa gjërave - mëshirë për ju, jo nga harresa - ju mos ekzaminoni (hulumtoni) në to". Muslimani është i urdhëruar ti zbatoj detyrat obligative. Gjithashtu është i obliguar t'iu shmangët ndalesave fetare dhe të jetë i përmbajtur në korniza ligjore Islame. Nga hadithi nxirret përfundimi: Moseksplorimi (kërkimi) i gjërave për të cilat ka heshtur Feja Islame.

31. Transmetohet nga Ebul-Abbas Sehl b. Sead Es-Saidij radijellehu anhu, i cili ka thënë: Erdh një njeri te Pejgamberi, salallahu alejhi ve seleme dhe tha: O i Dërguari i Allahut: Më trego një punë, të cilën nëse e punoj do të më dojë Allahu dhe do të më duan njerëzit? "Përmbahu (bëhu asket) në këtë botë do të dojë Allahu, kurse përmbahu nga ajo që është te njerëzit do të duan njerëzit". Hadithi sugjeron zhvlerësimin e kësaj bote njëkohësisht tërheq vëmendjen nga mashtrimi i saj. Bindja në atë që posedon Allahu duhet të jetë më e fortë ndaj asaj që posedon njeriu.

32. Transmetohet nga Ebu Saidi, Sa'd b. Sinan El-Hudrij, radijellahu anhu se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Nuk lejohet shkaktimi i dëmit ndaj (atij që nuk ka dëmtuar) as ndaj (atij që ka dëmtuar) në mënyrë jo të ligjshme." Ky hadith llogaritet çereku i jurisprudencës islame. Hadithi në fjalë ka shkaktuar që juristët islam të nxjerrin dispozita dhe nëndispozita themelore të Sheriatit Islam: dëmi shuhet sipas mundësisë, dëmi mënjanohet, dëmi nuk mënjanohet me mekanizëm të ngjashëm, dëmi i rëndë shpaguhet me dëm më të lehtë, dëmi individual ndaj dëmit shoqëror rezistohet.

33. Transmetohet nga Ibn Abbasi, radijellahu anhu, se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve seleme, ka thënë: " Sikur njerëzve t'iu jepej ajo që ata kërkojnë do të kishte të tillë që kërkojnë pasurinë dhe jetën e të tjerëve. Ai që paditë duhet të paraqes dëshmi kurse betimi është për atë që e mohon (padinë)." Ai që paditë duhet të sjell dëshmi, ndërkaq betimi mbetet për të akuzuarin në rastë të mohimit të akuzës.

34. Transmetohet nga Ebu Said El-Hudriu, radijellahu anhu, i cili ka thënë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut salallahu alejhi ve seleme, duke thënë: "Kush e sheh nga ju ndonjë të keqe le ta ndryshojë me dorën e vetë e nëse nuk mundet atëherë me gjuhë por nëse nuk mundet atëherë me zemër mirëpo kjo është (shkalla) e besimit më të dobët". Vepra e keqe luftohet sipas mundësisë, përkatësisht, mekanizmit të cilin e posedon muslimani. Vepra e keqe duhet ndalur me dorë, nëse nuk është e mundur me dorë atëherë duhet këshilluar, nëse edhe kjo nuk mund të ndodhë atëherë më së paku që mund të bëhet të mos pajtohet me zemër me atë që bënë vepra të këqija por kjo ndodhë me muslimanin që ka rënë niveli i besimit të tij në shakllën më të ultë.

35. Transmetohet nga Ebu Hurejreja radijellahu anhu, i cili ka thënë: i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve seleme, ka thënë: "Mos xhelozoni, mos ngritni çmimin (gjatë shit-blerjes), mos urreni, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos garoni në shitblerje dhe bëhuni robër të Allahut, vëllezër. Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bënë padrejtësi, nuk e tradhton, nuk e gënjen, nuk e nënçmon. Dëvotëshmëria është këtu duke bërë me shenjë në krahërorin e tij tri herë. Urrejta ndaj vëllait të vetë mjafton për njeriun t'i llogaritet vepër e keqe. Muslimani ndaj muslimanit ka të ndaluar - është haram: gjakderdhja, pasuria dhe nderi i tij". Nga hadithi nxirret përfundimi: Morali i keq sipas Sheriatit islam është krim i pikëzuar. Zemra është ajo nga e cila buron frika dhe droja ndaj Allahut xh.sh.

36. Transmetohet nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, ky nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë: "Kush ia lehtëson besimtarit një brengë nga brengat e kësaj bote, Allahu nga ai do ta largojë një brengë nga brengat e Ditës së Kijametit. Kush ia lehtëson atij, i cili është në vështirësi, Allahu do t'ia lehtësojë atij në këtë dhe botën tjetër. Kush ia mbulon (një të metë) muslimanit, Allahu do t'ia mbulojë atij në këtë dhe në botën tjetër. Allahu do të jetë në ndihmë të robit, gjersa ai është në ndihmë të vëllait të tij. Kush ndjek rrugën që në të të kërkojë dituri, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në xhennet. Asnjëherë nuk do të tubohen grup njerëzish në një shtëpi të Zotit që të lexojnë Librin e shenjtë (Kur'an) dhe të studiojnë atë dhe mbi ata të mos zbresë qetësia dhe t'i mbulojë mëshira, t'i rrethojnë engjujt, dhe Allahu të mos i përmend ndër të zgjedhurit e Tij. Atë që vepra e tij (e mirë jo e përsosur) e ka frenuar nuk mund krenaria e prejardhjes me e lartësuar". Shpërblimi te Allahu xh.sh. do të jetë prej llojit të veprave që ka paraqitur njeriu. Shpërblimi për lehtësi do të jetë lehtësimi kurse për mosbesnikëri do të jetë pakënaqësia. Shpërblimi për mbulesë do të jetë mbulesa. Nga hadithi nxirret përfundimi: Udhëzimi i zemrave për në rrugë të drejtë është kompetencë e Krijuesit të gjithësisë. Besimtari duhet vazhdimisht të kërkojë udhëzimin e Allahut xh.sh. që ta udhëzojë. Nga hadithi konstatohet vlera e leximit dhe e studimit të Kur'anit famëlartë si dhe vlera e pendimit dhe të kërkuarit falje nga Zoti i botrave.

37. Transmetohet nga Ibn Abbasi, radijellahu anhu, ky nga i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve seleme, i cili ka treguar nga Zoti i tij i Madhëruar: "Vërtetë Allahu i ka caktuar veprat e mira dhe veprat e këqija. Pastaj këtë e ka sqaruar: ai i cili ka vendosur të bëjë një vepër të mirë, por atë nuk e ka bërë. Te Allahu ajo (vepër) do të shkruhet vepër e mire, e plotë. Por, ai që ka vendosur të bëjë një vepër të mirë dhe e ka zbatuar, Allahu do t'i shkruaj në Madhërinë e Tij dhjetë vepra të

mira, deri në shtatëqind shpërblime dhe më shumë. Ai që ka vendosur të veprojë një vepër të keqe por nuk e ka zbatuar, Allahu do ta shkruaj atë vepër si vepër të mirë, të plotë, por nëse ka vendosur të bëjë një vepër të keqe por nuk e ka zbatuar, Allahu do të shkruaj në Madhërinë e Vetë, një vepër të keqe". Mëshira e Allahut ndaj besimtarëve është e gjerë, falja e Tij është gjithpërfshirëse dhe dhuntitë e Tij janë të pakufizuara. Allahu xh.sh. nuk do të dënoj atë i cili ka menduar të veproj një vepër për derisa ai të mos e realizoj atë vepër. Nga hadithi nxirret përfundimi: Besimtari gjithnjë duhet të vendos që të bëjë vepra të mira duke shpresuar gjithnjë në shpërblimin e Allahut fuqiplotë.

38. Transmetohet nga Ebu Hurejre, radijellahu anhu, i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve seleme, ka thënë: "Vertetë Allahu i Madhëruar, ka thënë: Ai që tregon armiqësi ndaj mikut (besimtarit) Tim, Unë atij do t'i shpall luftë. Nuk mund të afrohet robi te Unë me diç më të dashur për Mua se sa me ato gjërat me të cilat e kam obliguar (farzet). Robi Im vazhdon të afrohet te Unë me ibadete nafile derisa atë Unë ta dua. E kur atë Unë ta dua, do të jem të dëgjuarit e tij që dëgjon, të pamurit e tij që sheh, dora e tij me të cilën punon dhe këmba e tij me të cilën ecë. Nëse ai kërkon prej Meje diç, do t'i përgjigjem, e nëse kërkon mbrojtje nga Unë, do ta mbrojë". Besimtari i sinqertë dhe i dëvotshëm çmohet dhe respektohet për faktin se ai ka flijuar veten në zbatimin e urdhërave të Allahut xh.sh.

39. Transmetohet nga Ibn Abbasi, radijellahu anhuma, se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme, ka thënë: "Vërtetë Allahu nga ummeti im e ka fshij (zhduk) mëkatet që shkaktohet pa qëllim, nga harresa dhe nga presioni". Allahu i madhërishëm nuk i merr parasysh mëkatet që shaktohen pa qëllim, nga harresa ose nga presioni i jashtëm. Nga ana tjetër mëkati i shkaktuar me përcaktim dhe vendosmëri merret parasysh dhe përcaktohet dënimi enkas për të. Nga hadithi nxirret përfundimi: Pas Çdo vështirësie pason lehtësimi.

40. Transmetohet nga ibn Omeri radijellahu anhuma, i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem, më kapi për dy krahërorët dhe, më tha: "Bëhu në këtë botë sikur të jesh i huaj ose udhëtar". Ibn Omeri radijellahu anhuma, thoshte: Kur të flejsh mos e pritë mëngjesin, kur të zgjohesh, mos e pritë mbrëmjen. Shfrytëzo shëndetin para sëmundjes, shfrytëzo jetën para vdekjes. Besimtari duhet të nxitoj për të bërë vepra të mira, të shtoj respektin dhe nënshtimin ndaj urdhërave të Fesë për faktin se nuk dihet çasti i vdekjes kur do të ndodhë.

41. Transmetohet nga Ebu Muhamed, Abdullah ibn Amr ibn El-Asi, radijellahu anhuma, i cili ka thënë: i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve seleme, ka thënë: "Askush prej jush nuk ka besimin e përsosur, për deri sa pasionet e tij të mos pasojnë atë për çka jam dërguar". Veprat duhet të jenë në kontinuitet të plotë me Librin e Allahut (Kur'anin) dhe Sunnetin e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem. Pjesë urgjente e besimit është asistenca e sunnetit të Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem.

42. Transmetohet nga Enesi, radijellahu anhu, i cili ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut salallahu alejhi ve seleme: "Allahu i madhëruar, ka thënë: O biri i Ademit, për deri sa më lutesh Mua dhe shpreson te Unë, do të falë të gjitha çka ke vepruar. O biri Ademit sikur që mëkatet tua të arrijnë te vranësiat në qiell, nëse kërkon falje nga Unë, Unë do të falë. O biri Ademit, nëse te Unë vjen me mëkate të mëdha sa toka pastaj më ke takuar Mua pa mos me më përshkruar shok edhe Unë do të vij me të njejtën sasi me falje". Lutja është shkak që inicon pranimin e saj pasi të ishin plotësuar të gjitha kushtet paraparake. Motivi kryesorë i faljes së mëkateve është besimi në Allahun Një, ai që posedon momoteizmin e posedon motivin kryesor të faljes kurse ai që nuk e posedon, nuk e posedon mekanizmin kryesorë.